



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:206586

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05465361

Ac.nr.98/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku - kryetar i kolegjit, Besnik Feka dhe Bujar Muzaqi- anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.P, të cilin e përfaqëson me autorizim avokati L.D, kundër të paditurit M.A, të cilin e përfaqëson me autorizim avokati N.S, për pasurim të pa bazë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Graçanicë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.101/16, të datës 15.10.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më 12/03/2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurit M.A dhe PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Graçanicë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.101/16, të datës 15.10.2019, dhe çështja kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.101/16 të datës 15.10.2019 ka vendosur si në vijim:

I.APROVOHET SI E THEMELTË kërkesëpadi e paditësit R.P.

II.DETYROHET i padituri M.A, për shkak të pasurimit të pa bazë, t'ia paguaj paditësit R.P, shumën prej 23.640,00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 05.12.2018 (data e nxjerrjes së ekspertizës) deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

III.DETYROHET i padituri M.A, që paditësit R.P që në emër të shpenzimeve të procedurës t'ia paguaj shumën prej 3.971,40 euro, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur pala e paditur, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të

plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të themeltë, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta prish duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pa themeltë e po ashtu të obligohet paditësi që të paditurit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në vlerën e përgjithshme prej 3.694,40 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Paditësit, përmes përfaqësuesit të tij me autorizim ka ushtruar përgjigje në ankesë, duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet ankimore të të paditurës, me propozimin që Gjykata e Apelit ta refuzojë ankesën si të pa themeltë, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta vërtetojë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe nenit 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit R.P dhe M.P, me datë 09.09.2016, ka ushtruar padi kundër të paditurit M.A, për shkak të pasurimit të pa bazë, me kërkesë të përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit ankimor.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilën e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve duke arsyetuar se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë P.Nr. 3157/12 të datës 10.07.2015, i pandehuri M.A është shpall fajtor për veprën penale Kontraktimi i përfitimit pasuror jo proporcional nga neni 270 paragrafi 1 i KPPRK-së, ku në cilësinë e palës së dëmtuar ishin paditësi R.P dhe M.P. Ndërgjyqësit me marrëveshjen e datës 28.10.2009, janë dakorduar që paditësi R.P si kryerës i punimeve t'ia ndërton shtëpinë të paditurit si porositës i punimeve-investitor, me çmim kontraktues prej 255 euro për m2 sipas sistemit me çelës në dorë apo në shumë të përgjithshme prej 35,000.00 euro, ku punimet janë paraparë të fillojnë me datën 09/11/2009 dhe të përfundojnë brenda 60 ditëve, mandej në arsyetim të aktgjykimit të atakuar është theksuar se nga deklarata e M.P rezulton se rasti ka ndodh në vitin 2008, kur e ka hapur një kafe në Graçanicë, M. kishte ardhur në kafe dha kishte ofruar 1000 euro të cilat M. i kishte pranuar për të zhvilluar biznesin me normë të interesit 10-15% dhe deri në vitin 2009 kredia me interes kishte arritur në vlerë prej 22.000 euro e për të cilin borxh i kishte treguar paditësit R.P i cili është takuar me të paditurin M. dhe janë dakorduar që borxhin t'ia kompensoj duke ia ndërtuar shtëpinë, ndërsa nga deklarata e paditësit R.P i dëgjuar në cilësinë e palës rezulton se me datën 28.10.2009 e ka arritur marrëveshjen për ndërtimin e shtëpisë së të paditurit në vlerë prej 35000 euro dhe gjatë ndërtimit kemi nënshkruar edhe një aneks kontratë me vlerë prej 6500 euro për rritjen e sipërfaqes ndërtimore dhe aneks kontratë tjetër në vlerë prej 1100 euro për punët tjera ndërtimore dhe sipas ekspertizës financiare të punuar nga eksperti R.B është vërtetuar se i padituri M.A nuk i ka shlyer detyrimet, ndaj paditësit R.P, për punët e kryer ndërtimore në shumë: 23,640.00 euro. Për sa i përket prapësimit të të paditurit duke u thirrur në parashkrim e kërkesëpadisë së paditësit, gjykata vlerësoi se prapësimi është i pathemeltë pasi që në rastin konkret aplikohet afati dhjetëvjeçar i parashkrimit sipas nenit 361 të LMD-së, me ç'rast afati i parashkrimit ka filluar të rrjedh nga momenti kur Aktgjykimit P.nr. 3157/12 të datës 10.07.2015 të Gjykatës Themelore në Prishtinë është bërë i plotfuqishëm. Për sa i përket shpenzimeve të procedurës, gjykata vendimin e bazoi në nenin 449 paragrafi 2, 452 paragrafi 1, 463 paragrafi 4 dhe nenit 473 paragrafi 2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe si i tillë nuk mund të pranohet, pasi që aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të paraparë me nenin 182.1 e lidhur me nenin 8, nenin 183 dhe nenin 184 të LPK-së.

Kolegji i Gjykatës së Apelit e Kosovës, pas analizimit dhe shqyrtimit me kujdes të shtuar të provave që gjenden në shkresat e lëndës e në raport me pretendimet ankimore erdh në përfundim se ankesa është e bazuar, për arsye se gjykata e shkallës së parë, aktgjykimin e atakuar e ka marrë me shkelje të nenit 8 të LPK-së, për arsye se nuk i ka vlerësuar me kujdes të veçantë secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe si rezultat nuk ka arritur që të vërteton drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, gjegjësisht gjykata e shkallës së parë nuk e ka sqaruar në detaje se kërkesëpadia e paditësit a ka të bëjë me kompensim demi mbi bazën e aktgjykimit penal, me nulitet të kontratës apo kemi të bëjmë me mos përmbushje të kontratës për ndërtim e shtëpisë e lidhur ndërmjet ndërgjyqësve e cila rrethanë është e rëndësishme të sqarohet, me qëllim që të aplikohet drejt e drejta materiale, gjegjësisht nuk është vërtetuar mjaftueshëm dhe në mënyrë bindëse se në rastin penal a ka qenë i përfshirë në shqyrtim edhe raporti kontraktual i datës 09/11/2009. Nëse rezulton se në procedurën penale është konstatuar se kontrata për ndërtimin e shtëpisë ka qenë në kundërshtim me rendin juridik të Republikës së Kosovës, gjykata e shkallës së parë e ka pasur për obligim që sipas detyrës zyrtare të anuloi kontratën në fjalë konform nenit 95 të LMD-së dhe të detyroj të paditurin që në bazë të nenit 90 par.1 të LMD-së, t'ia kthej palës atë që e ka marr në bazë të kontratës ose të bëjë kompensimin në të holla sipas ekspertizës nga fusha kompetente, prandaj si rezultat i mos vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim të gabuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me pasurim të pa bazë, për arsyes se kur ekziston një punë juridike e vlefshme, atëherë në këtë rast nuk mund të plotësohen kushtet ligjore që të aplikohet instituti juridik i pasurimit të pa bazë sepse baza mbi të cilën pretendohen se janë dhënë prestimet është kontrata për ndërtimin e shtëpisë e lidhur ndërmjet ndërgjyqësve me datën 09/11/2009 e cila kontratë nuk është vlerësuar nga ana e gjykatës në raport me aktgjykimin penal se a është në harmoni me dispozitat urdhëruese apo jo. Mandej, me ekspertizën financiare nuk mund të vërtetohen të gjitha faktet vendimtare lidhur me këtë çështje kontestimore sepse mendimin dhe konstatimin lidhur me vlerën e punëve ndërtimore e jep eksperti i ndërtimtarisë dhe jo eksperti financiar i cili është bazuar në parametra jo bindës dhe e njëjta ekspertizë është kontradiktore me vet vetën, ngase në faqen 6 të saj eksperti thekson se obligimi i të paditurit ndaj paditësit është në shumë prej 29,767.00 euro, ndërsa në faqen 10 të ekspertizës konstatohet obligimi për punët ndërtimore janë në shumë prej 23,640.00 euro. Prandaj, mos vërtetimi i këtyre fakteve relevant, ka rezultuar me zbatim të gabuar të së drejtës materiale të paraparë me nenin 194.1 të LMD-së e cila dispozitë parasheh: *Secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar të kthejë atë që ka marrë nga tjetri, ose ndryshe të kompensojë vlerën e fitimit të arritur.*

Gjykata e shkallës së parë gabimisht po ashtu e ka aplikuar nenin 361 të LMD-së e cila dispozitë parasheh: *Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim.* Në rastin konkret kjo dispozitë ligjore aplikohet në procedurën përmbartimore dhe jo në procedurën kontestimore sepse kërkesa e paditësit ndodhet në procedure kontestimore dhe të njëjtat nuk janë vërtetuar me aktgjykim të formës së prerë, respektivisht afati 10 vjeçar i parashkrimit fillon të rrjedh nga dita kur aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm e që në këtë situatë juridike aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.3157/12 e datës 10/07/2015 i cili është i plotfuqishëm me datën 20/08/2015, rezulton se nuk e ka gjykuar kërkesën pasurore juridike të dëmtuarve-paditësit, por të njëjtit i ka udhëzuar në

kontest të rregullt civil. Gjykata e shkallës së parë, vetëm pas vërtetimit të drejt të bazës juridike të kërkesëpadisë, mundet ta shqyrtoj pretendimin e të paditurit lidhur me institutin e parashkrimit, ngase e drejta materiale për secilën bazë juridike e rregullon afatin e parashkrimit sipas nenit 96, 357 apo 358 të LMD-së, varësisht se në cilën bazë përcaktohet gjykata mbi bazën e gjendjes faktike që do ta konstatoj.

Gjatë procedurës gjyqësore objekt i të provuarit duhet të jenë të gjitha faktet relevante, të cilat janë në ndikim në vendosjen e çështjes. Gjykata ka për detyrë që gjendjen faktike të vërtetohet në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe në këtë drejtim duhet të kujdeset që të administrohen të gjitha provat të cilat janë thelbësore për epilogun e kontestit. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë pa e vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë, respektivisht pa vlerësuar vlefshmërinë e provave kontestuese dhe pa qartësuar bazën juridike të krijimit të detyrimit e aprovoj kërkesëpadinë e paditëses. Prandaj, shkeljet e tilla të cekura më lartë përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë, andaj aktgjykimi i atakuar doemos është dashur të priset.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkeljen e dispozitave të sipërcituara, të cilat në ri procedurë duhet të eliminohen në atë mënyrë që të vërteton bazën juridike të kërkesëpadisë sipas vërejtjeve të sipër theksuara dhe nëse vlerësohet se për vërtetimin e fakteve vendimtare është e nevojshme të sigurohen shkresat penale P.nr.3157/12, atëherë të njëjtat ti kërkoj nga Gjykata Themelore në Prishtinë, ndërsa lidhur me vërtetimin lartësisë së kërkesëpadisë duhet të nxjerrët prova materiale me ekspertizë nga fusha e ndërtimtarisë, në atë mënyrë që të vërtetohet vlera e saktë e punëve ndërtimore, e po ashtu pas pranimit të ekspertizës së ndërtimtarisë, të ftohet eksperti financiar që në bazë të gjeturave nga eksperti i ndërtimtarisë, ti eliminoj vërejtjet e lartcekura, ashtu që ekspertët gjyqësor duhet të vërtetojnë në mënyrë bindëse lartësinë e kërkesëpadisë si dhe gjykata gjatë vendimmarrjes duhet ti vlerëson të gjitha faktet me rëndësi vendimtare sipas kërkesave dhe kundërshtimeve të palëve, me qellim që të nxjerrë një vendim të ligjshëm dhe të drejtë.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (c) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.98/20, me datë 12.03.2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku